

RAPORTI I RREGULLT EKONOMIK PËR
BALLKANIN PERËNDIMOR nr. 24 | Vjeshtë 2023

Drejt rritjes së qëndrueshme

MAQEDONIA E VERIUT



Maqedonia e Veriut

- Megjithëse ekonomia ka treguar një qëndrueshmëri ndaj krizave, konsumi është duke u ngadalësuar për shkak të rritjes së harxhimeve për jetesë, ndërsa prodhimtaria lufton me ngadalësimin e kërkesës së jashtme.
- Financat publike janë të mbingarkuara për shkak të rritjes së harxhimeve për huamarrje. Konsolidimi fiskal duhet të ketë përparësi në mënyrë që të mund të alimentohen detyrimet më të mëdha të marra për paga dhe investime publike.
- Inflacioni bazë ngadalësohet, por parashikohet të jetë i lartë edhe më tej në vitin 2023, ndërsa deri në vitin 2025 të bie në mesataren shumëvjeçare. Megjithatë, presionet e pagave mund të çojnë në presione të zgjatura inflatore.
- Gjasat afatmesme janë pozitive, por mbizotërojnë rreziqet për zvogëlimin e rritjes. Nxitja e rritjes dhe përshpejtimi i konvergencës së të ardhurave kërkon zbatimin e reformave shumë të nevojshme që janë ngecur nga bllokimi afatgjatë të kuvendit.

Zhvillimet e fundit ekonomike

Rritja ekonomike filloi të ngadalësohet në tremujorin e dytë të vitit 2023. Pas rritjes prej 2,1 për qind në K1 2023, rritja e bazës vjetore në K2 2023 ishte vetëm 1,2 për qind, nxitur nga konsumi privat ndërsa eksportet dhe investimet kapitale bruto u ulën ndjeshëm pasi kërkesa e jashtme u ngadalësua dhe rezervat u pakësuan. Po ashtu, konsumi u zvogëluar deri në 1,6 për qind (zvogëlim për 1,1 pp nga tremujori paraprak) meqë inflacioni i lartë i vazhdueshëm e uli fuqinë blerëse të amvisërive. Në përgjithësi, rritja në gjysmën e parë të vitit 2023 ishte 1,6 për qind, dhe sa për krahasim, rritja në gjysmën e parë të vitit ishte 3,1 për qind. Në anën e prodhimtarisë, rritjen në gjysmën e parë të vitit 2023 e lëviznin shërbimet dhe industria, ndërsa ndërtimtaria dhe bujqësia edhe më tej shënonin rezultate më të këqija. Pas rritjes së ashpër në K1, në K2, ndërtimtaria shënoi rënie prej 22 për qind edhe përkaj asaj që filluan të ndërtohen seksionet e autostradës së Korridorit 8 dhe 10.

Të dhënat me frekuencë të lartë tregojnë për një ngadalësim të rritjes në tremujorin e tretë të vitit 2023. Në korrik, prodhimi industrial u ul për 1,7 për qind¹ me rënie në xehetari dhe industrinë e përpunimit dhe intensifikim të prodhimit të energjisë. Ulja e numrit dhe të vlerës së lejeve të lëshuara për ndërtim deri në qershor mund të ngadalësojë aktivitetin në ndërtimtari në muajt e ardhshëm, në korrik të vitit 2023 tregtia me pakicë shënoi rënie prej 3,9 për qind. Turizmi shënon përmirësim të vazhdueshëm gjatë sezonit të verës, por numri i mysafirëve dhe qëndrimeve nuk e arritën nivelin e para krizës.

U ul çekuilibri në sektorin e tregtisë së jashtme. Deri në K2 2023² deficiti i llogarisë rrjedhëse (korrente) u ul në 1,1 për qind të PBB, kryesisht për shkak të përmirësimit të bilancit të tregtisë me mallra. Me zbutjen e presioneve nga importi i energjisë, deficiti i tregtisë së jashtme u zvogëluar për më shumë se 6 pikë përqindje (pp), në 20.5 për qind të PBB-së. Njëkohësisht, suficiti të shërbimet u ul në

1 Në bazë vjetore.

2 Për katër tremujorët e fundit.

4,8 për qind të PBB si rezultat i harxhimeve për punët infrastrukturore publike. Deficiti primar i të ardhurave kryesisht mbeti i pandryshuar edhe krahas rritjes së pagesës së kamatave, ndërsa suficiti i llogarisë dytësore mbeti i lartë i mbështetur nga remitencat solide. Flukset hyrëse të IHD u dobësuan deri në 4.7 për qind të PBB-së, por megjithatë ndihmuan në financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe rritjen e rezervave valutore bruto. Deri në mars të vitit 2023, borxhi i jashtëm bruto ka rënë në rreth 76.9 për qind të vlerësuar të PBB.

Edhe krahas mbështetjes së konsiderueshme nga Qeveria edhe më tej mbeten sfidat strukturore në tregun e punës. Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në K2 2023³ u rit në krahasim me tremujorin paraprak në 52,4 për qind. Mirëpo, shkalla e pjesëmarrjes e grave edhe më tej është për 20 pp më e ulët nga ajo e burrave. Kujdesi për fëmijët dhe më të moshuarit përmendet si një nga arsytet parësore për jo aktivitetin e grave, ndërsa kompanitë në Maqedoninë e Veriut janë më pak të përgatiturat në rajon për të ofruar kujdes për fëmijët ose kushte elastike për punë.⁴ Shkalla e punësimi është rritur për 0,4 pp, në 45,5 për qind, ndërsa shkalla e papunësisë është ulur në 13,1 për qind si rezultat i numrit më të madh të vendeve të punës për grup-moshat më të reja dhe i daljes të grup-moshave më të vjetra nga popullsia e aktive. Shkalla e papunësisë së të rinjve është ulur në 25,6 për qind, por edhe më tej është konsiderueshëm më e lartë nga mesatarja e BE.

Rritja e vazhdueshme e pagave nga muaji prill i vitit 2023 është më i shpejtë se inflacioni. Rritje e pagave është shënuar në të

gjithë sektorët ekonomik në gjysmën e parë të vitit, e nxitur nga rritja e detyrueshme e pagës minimale. Për punonjësit në ndërtimtari, administratë dhe arsim, rritja e pagave ishte mbi mesataren. Pagat do të rriten edhe më tepër, meqë Qeveria në gusht të vitit 2022, nënshkroi marrëveshje të re kolektive për sektorin publik, me të cilin parashikohet rritje prej 10 për qind të pagave nga shtatori i vitit 2023, rishikim i metodologjisë për përcaktimin e pagave nga viti 2024 me të cilën paga bazë lidhet me pagën bruto kombëtare, regres për pushim vjetor në lartësi prej 30 për qind të pagës mesatare neto dhe shpërblime për besnikëri.

Inflacioni bazë është zvogëluar në numra një shifror në qershor të vitit 2023 pasi në tetor të vitit 2022 arritën në 19,8 për qind. Masat e Qeverisë për kontroll të çmimeve të produkteve themelore ushqimore ndihmuan përkohësisht në frenimin e rritjes së çmimeve përgjegjës për gjysmën e rritjes së inflacionit në gjysmën e parë të vitit 2023. Me stabilizimin e çmimeve të ushqimit dhe energjisë, shkalla e inflacionit në gisht të vitit 2023 u zvogëluar në 8,3 për qind. Megjithatë, efektet ndërmjetëse dhe përhapja e mbajtën inflacionin bazë në rreth 8 për qind. Pritjet për inflacionin në K2 2023 janë 9,3 për qind për vitin 2023 edhe përskaj përmirësimit të butë në krahasim me raundin paraprak të anketës nga K1 2023.

Shtrengimi i politikës monetare vazhdoi me vijimin e presioneve inflatore. Deri në gusht të vitit 2023, Banka qendrore e rriti normën e interesit në 6,15 për qind, nga niveli më i ulët historik prej 1,15 për qind para fillimit të ciklit të shtrengimit në pranverë të vitit 2022. BPRMV kishte për qëllim edhe të nxit

3 Të dhënat për K1–K2 2023 nuk janë plotësisht të krahasueshme me të dhënat paraprake për fuqinë punëtore për shkak të ndryshimeve në metodologji dhe rishikimin e mostrës në bazë të regjistrimit të vitit 2021. Të gjithë numrat janë në bazë të krahasimit të tremujorit me tremujor.

4 Eurostat, Anketë e bizneseve Ballkan barometër 2023.

procesin e denarizimit të bilanceve të bankave përmes rritjes së rezervës së detyrueshme për obligime në valutë të huaj nga 19 në 20 për qind. Kursi i denarit i lidhur me euron edhe më tej është i qëndrueshëm, ndërsa rezervat valutore u rimëkëmbën nga humbjet të cilat i pësuan kryesisht nga shpërthimi i luftës në Ukrainë dhe në qershor të vitit 2023 ishin në nivelin e eksportit 4 mujor. Qëndrueshmëria e sektorit bankar u ruajt me rritjen e shkallës së mjaftueshmërisë së kapitalit në 18 për qind në K1 2023. Njëkohësisht, shkalla e kredive jofunksionale u zvogëluar në 2,8 për qind. Rritja kreditore u ngadalësua deri në 5,8 për qind në korrik të vitit 2023, kryesisht për shkak të huamarrjes së zvogëluar të kompanive si rezultat i përkeqësimit të kushteve financiare.

Vazhduan presionet fiskale. Deficiti publik në vitin 2023 me gjasë të do të mbetet i lartë si edhe në vitin 2022. Deficiti i qeverisë së përgjithshme (me Ndërmarrjen publike të Rugëve Shtetërore) në vitin 2023 parashikohet të jetë 4.8 për qind nga PBB, me rialokimin e fondeve në buxhet për përmbushjen e detyrimeve të reja të pagave. Implikimet fiskale të kontratës kolektive për sektorin publik vlerësohen mesatarisht 0,7–0,8 për qind nga PBB në vit dhe i shtohen rritjes së mëparshme të pagës minimale dhe rritjes së pagave të zyrtarëve publik. Deri në qershor të vitit 2023, deficiti i qeverisë së përgjithshme arriti në 2,6 për qind nga PBB, ndërsa të hyrat nga TVSh u zvogëluar, ndërsa investimet dhe shpenzimet sociale u rritën. Njëkohësisht, grumbullimi i të ardhurave në bazë të tatimit në fitim u rrit meqenëse disa nga kompanive në ZTIZh u përfundoi përjashtimi nga taksat. Miratimi i fundit i taksës së solidaritetit, si dhe reformat e TAK-së dhe TVSH-së do të lehtësojnë pak presionin për K4 2023.

Borxhi publik dhe borxhi i garantuar publik është mjaft mbi nivelin e para krizës. Me 59,1 për qind e PBB në qershor të vitit 2023, borxhi publik është për 10 pp mbi nivele e vitit 2019. Inflacioni ndihmoi të ulet një pjesë e borxhit ndaj BPP, por borxhi publik nominal vazhdon të rritet. Detyrimet e prapambetura mbeten vazhdimisht mbi 3 për qind nga PBB, kryesisht për shkak të mos pagesës nga ndërmarrjet shtetërore, sektori shëndetësor dhe pushteti vendor. Si pjesë e marrëveshjes PLL me FMN-në, Qeveria është angazhuar të reduktojë pagesat e prapambetura ndaj sektorit privat.

Perspektivat dhe rreziqet

Perspektiva afatmesme është pozitive, por mbizotërojnë rreziqet nga zvogëlimi i rritjes. Rritja në vitin 2023 pritet të rritet në mënyrë modeste deri në 1,8 për qind, duke e pasqyruar ngadalësimin tek partnerët kryesorë tregtar të vendit si pasojë e tërthortë e luftës në Ukrainë. Rritja pritet të përshpejtojë në mënyrë të matur në afat të mesëm e nxitur nga rritja e investimeve publike dhe nga rimëkëmbja e konsumit përpara ngadalësimit drejt rritjes potenciale. Borxhi publik pritet të rritet në afat të mesëm, si rezultat i ndërtimit të seksioneve të autostradave të Korridorit 8 dhe 10d dhe të rritjes së pagave. Deficiti fiskal është projektuar të shënojë rënie nën 3 për qind e PBB madje pas vitit 2027.

Me stabilizimin e çmimeve të mallrave të bursës, norma e inflacionit deri në vitin 2025 pritet të shënoje ulje, deri në mesataren e shënuar afatgjate. Nën supozimin që ndikimi i krizave do të zvogëlohet në periudhën e prognozuar, inflacioni pritet të zvogëlohet në 9,1 për qind në vitin 2023 edhe deri në vitin

2025 të bie në nivelin e mesatares së shënuar afatgjate prej 2 për qind. Shtrëngimi i politikës monetare pritet të vazhdojë në afat të shkurtë, por gradualisht të zbutet pasi të jenë ulur presionet mbi çmimet.


Edhe pse rreziqet bazë mbeten edhe më tej dhe i pasqyrojnë perspektivat e partnerëve kryesor tregtar të vendit, përafrimi i negociatave për anëtarësim në BE mund t'i përshpejtojë reformat kritike dhe të nxit rritjen. Megjithatë, pasiguria e theksuar politike dhe bllokada e zgjatur e parlamentit për shkak të mungesës së konsensusit për ndryshimet kushtetuese dhe zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe presidenciale në gjysmën e parë të vitit 2024 mund të vonojnë zbatimin e reformave. Së fundi, dështimi i politikave mund të dobësojë qëndrueshmërinë fiskale dhe të forcojë qëndrueshmërinë e inflacionit, duke bërë të nevojshme shtrëngimin e mëtejshëm të politikës monetare që mund të kufizojë më tej mundësitë e financimit dhe të ngadalësojë aktivitetin ekonomik në të ardhmen.

Krizat të cilat u ndërlidhën njëra me tjetrën e dëmtuan potencialin për rritje dhe edhe më tej e ngadalësuan përafrimin me BE. Kalimi nga një vend me të ardhura mesatare në një vend me të ardhura të larta kërkon nisjen e reformave dhe ballafaqim me kufizimet kritike për rritjen e ardhshme. Aktivitetet e politikave duhet të jenë të orientuara kah rivendosjes së mekanizmave mbrojtës dhe zvogëlimin të cenueshmërisë nga goditjet e ardhshme. Nxitja e produktivitetit, avancimit në përfshirjen dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe të mjedisit jetësor janë kritike për rritjen afatgjate të vazhdueshme në kontekstin e pasigurisë së theksuar dhe gjerësisht të përhapur. Dekarbonizimi i ekonomisë dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë nga goditjet klimatike është i nevojshëm për ruajtjen

e konkurrencës ndërkombëtare të zbatimit të Mekanizmit të Rregullimit Ndërkufitar të BE-së. Rritja e shpenzimeve kapitale produktive si pjesë e buxhetit afatmesëm duke ruajtur qëndrueshmërinë fiskale do të ishte vendimtare për nxitjen e rritjes.

Rritja filloi të ngadalësohet ...


Përqindje të ndryshimit dhe kontributi në rritje



Burime: Enti shtetëror për statistika përllogaritje të staft të Bankës Botërore.

Norma e pjesëmarrjes është zvogëluar në vitin 2023.


Përqindjet



Burim: Enti shtetëror për statistika.
Vërejtje: APC 2021 dhe 2022 i shfrytëzohen të dhënat nga regjistrimi i vitit 2021. Në K1 2023 ka ndryshim metodologjik dhe së andejmi ka ndërprerje të serisë.

...ndërsa çekuilibri tregtar i jashtëm është ulur me uljen e importit.


Përqindje nga PBB



Burim: Banka Qendrore. 2023 është një mesatare e lëvizshme deri në qershor 2023.

...ndërsa të dhënat me frekuencë të lartë tregojnë ngadalësim në të ardhmen.


Përshtatur ndaj ciklit tregtar [ct], 2011=100



Burime: Enti shtetëror për statistika, përllogaritje të staft të Bankës Botërore.

Inflacioni gjatë verës u bë një shifror...


Përqindje, në nivel vjetor



Burim: Enti shtetëror për statistika.

Deficiti fiskal dhe borxhi janë rritur.

Përqindje nga PBB



Burime: Ministria e financave; vlerësimet të Bankës Botërore.
Vërejtje: Deficiti fiskal dhe përfshin Ndërmarrjen publike për rrugë shtetërore.

MAQEDONIA E VERIUT Tregues të përzgjedhur ekonomik	2020	2021	2022	2023e	2024f	2025f
Rritja reale e PBB-së (përqindje)	-4,7	3,9	2,1	1,8	2,5	2,9
<i>Përbërja (pikë përqindje)</i>						
Konsumi	-1,5	6,4	2,9	1,2	1,2	1,9
Investimet	-5,7	0,3	4,9	2,1	1,8	1,9
Eksporti neto	2,5	-2,7	-5,7	-1,5	-0,6	-0,9
Eksporti	-7,4	7,4	9,2	4,6	4,3	4,1
Importi (-)	-9,9	10,2	14,8	6,1	4,9	5,0
Inflacioni i çmimeve me pakicë (përqindje, mesatarja e periudhës)	1,2	3,2	14,2	9,1	3,0	2,0
Të ardhurat publike (përqindja e PBB-së)	29,9	32,5	32,4	34,9	35,0	35,7
Shpenzimet publike (përqindja e PBB-së)	38,1	37,9	36,9	39,4	39,2	39,2
<i>Nga të cilat:</i>						
Pagat (përqindja e PBB-së)	7,2	6,9	6,5	6,6	6,9	7,1
Kompensimet sociale (përqindja e PBB-së)	17,6	16,9	16,6	16,7	16,6	16,5
Shpenzimet kapitale (përqindja e PBB-së)	3,1	4,2	4,2	6,7	6,3	6,6
Bilanci fiskal (përqindja e PBB-së)	-8,2	-5,4	-4,5	-4,5	-4,1	-3,5
Bilanci total i buxhetit së bashku me Ndërmarrjen Publike për Rugët Shtetërore	-8,6	-5,8	-4,8	-4,8	-4,5	-3,8
Bilanci fiskal primar (përqindja e PBB-së)	-7,0	-4,1	-3,3	-3,2	-2,4	-1,5
Borxhi publik (përqindja e PBB-së)	50,8	52,0	50,9	51,7	53,3	54,5
Borxhi publik dhe i garantuar publikisht (përqindja e PBB-së)*	59,8	61,0	59,6	60,2	61,5	62,2
<i>Nga i cili: i jashtëm (përqindja e PBB-së)</i>	39,9	39,9	39,1	38,7	38,8	38,3
Eksporti i mallrave (përqindja e PBB-së)	44,4	51,3	57,0	56,8	57,5	58,5
Importi i mallrave (përqindja e PBB-së)	61,0	71,6	83,7	82,3	82,5	83,1
Eksporti neto i shërbimeve (përqindja e PBB-së)	3,9	4,2	5,7	6,9	7,3	7,6
Bilanci tregtar i mallrave dhe shërbimeve (përqindja e PBB-së)	-12,7	-16,0	-21,0	-18,6	-17,7	-17,0
Fluksi i remitancave (përqindja e PBB-së)	3,1	2,9	2,7	2,9	2,8	2,7
Gjendja e llogarisë rrjedhëse (përqindja e PBB-së)	-2,9	-3,1	-6,0	-3,7	-3,2	-2,8
Fluksi neto i investimeve të huaja direkte (përqindja e PBB-së)	1,4	3,3	5,2	5,2	4,7	4,2
Borxhi i jashtëm (përqindja e PBB-së)	78,7	81,9	84,2	80,0	82,7	82,8
Rritja reale e kreditimit për sektorin privat (përqindja, mesatarja për periudhën)	5,6	2,8	-4,2	-	-	-
Kreditë jofunksionale (përqindja e totalit të kredive në fund të periudhës)	3,3	3,1	2,8	-	-	-
Norma e papunësisë (përqindja, mesatarja e periudhës)**	16,4	15,4	14,4	-	-	-
Norma e papunësisë së të rinjve, (përqindja, mesatarja për periudhën)	35,7	36,3	32,5	-	-	-
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (përqindja, mesatarja e periudhës)	56,4	56,0	55,2	-	-	-
PBB për frymë, PPP (aktuale ndërkombëtare USD)**	13.562	14.096	14.398	14.657	15.024	15.459
Shkalla e varfërisë (përqindje nga popullata)	20,1	19,1	18,3	17,9	17,3	16,2

Burim: Autoritetet e vendit, vlerësimet dhe projeksionet e stafit të Bankës Botërore.

Vërejtje: *Përfshin borxhin e pasiguarar të PDS. **Të dhënat e 2021 dhe 2022 nuk janë plotësisht të krahasueshme për shkak të ndryshimit të mostrës së ARS bazuar në regjistrimin e vitit 2021. Të dhënat për vitin 2022 janë të dhënat më të fundit të disponueshme. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë është për fuqinë punëtore të moshës 15-24 vjeç, ër të matur dhe parashikuar varfërinë janë përdorur të dhënat e të ardhurave nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës. Vlerat e transmatura/të parashikuara fillojnë në vitin 2020. Masat e të ardhurave në SILC dhe masat e konsumit në ABEF nuk janë rreptësisht të krahasueshme. Varfëria përfuqizohet si jetesë me më pak se 6,85 dollarë amerikanë/ditë për person në PPP të rishikuar 2017. e = vlerësimi, f = parashikimi; - = i padisponueshëm.



Raporti i Rregullt Ekonomik për **Ballkanin Perëndimor**
nr. 24 | Vjeshtë 2023

Shikoni raportin online:
www.worldbank.org/eca/wbrer